



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1501, datë 10.02.2011

Për

“Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1454, datë 03.12.2010 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 10.02.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Mbylljen e procedimit administrativ të filluar me VKD nr. 1454, datë 03.12.2010 “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a” të shoqëruar nga materialet:

- Raport përmbledhës (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**Projektakti**);
- Dokumentet shkresore të palëve (**Provat, pretendimet**);

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1, neni 60 dhe neni 120 e vijues, të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);

3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Vendimi nr. 1454, datë 03.12.2010 i KD të AKEP “Për fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a”;
2. Shkresë Neofone sh.p.k nr. 57 Prot, datë 17.12.2010 (AKEP: nr. 3472/2 prot, datë 20.12.2010) “Parashtrimet përfundimtare në kuadër të Vendimit nr. 1454, datë 03.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP”;
3. Shkresë e Vodafone AL sh.a nr. LGD/0386/OX (AKEP: 3472/1 Prot, datë 09.12.2010) “Në lidhje me korrespondencën mbi tarifën e terminimit për thirrjet ndërkombëtare në rrjetin e Vodafone Albania, ndarje e kapaciteteve dhe zbatimin e VKD nr. 1437, datë 03.11.2010 dhe VKD nr. 1452, date 22.11.2010”;
4. Shkresë e Vodafone AL sh.a nr. CEO/0130/E.Xh datë 17.12.2010 (AKEP: 3472/3 Prot, datë 20.12.2010) “Dërgohen prapësimet e Vodafone AL në lidhje me Vendimin nr. 1454, datë 03.12.2010”.
5. Seanca dëgjimore e zhvilluar me datë 27.01.2011 në selinë e AKEP midis palëve;
6. Shkresa e Neofone nr. 64 prot, date 14.01.2011 (AKEP: nr. 101 prot, date 24.01.2011), “Disa shtesa në lidhje me ankimin administrativ në proces midis Neofone dhe Vodafone AL”;
7. Shkrese e Neofone nr. 66 prot, date 24.01.2011 (AKEP: nr. 109 prot, datë 26.01.2011) “Njoftim në lidhje me ndërprerjen e Aksesit të interkoneksionit nga ana e Vodafone AL dhe kërkesë për ndërhyrjen e menjëhershme të AKEP për hapjen e kapaciteteve të interkoneksionit”;
8. Korrespondencat me e-mail midis palëve te depozituara ne AKEP nga Vodafone AL dhe Neofone;
si dhe
9. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen,
10. Bazës ligjore të sipërcituar

V Ë R Ë N:

- I. Sipërmarrësi Neofone sh.p.k në vijim të pretendimeve, me shkresën nr. 57 prot, datë 17.12.2010, “Parashtrimet përfundimtare në kuadër të Vendimit nr. 1454, datë 3.12.2010, të Këshillit Drejtues të AKEP”, sqaron se:
1. Më datë 23.11.2010 Vodafone AL, ka hapur plotësisht aksesin në facilitetet ekzistuese me Neofone;
 2. Vodafone AL me shkresën nr. LGD/0369/OX datë 24.11.2010, pretendon pagesën e tarifës 0.15 euro/min, nga data 01.11.2010 deri më 23.11.2010;
 3. Neofone këtë tarifë e konsideron abuzuese dhe në përgjigje të saj me shkresën nr. 54 prot, datë 30.11.2010 i sqaron Vodafone AL, se pas VKD nr. 1437 datë 03.11.2010, tarifa e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare duhet të jetë në zbatim të këtij Vendimi;
 4. Vodafone AL, më datë 03.12.2010 ka dërguar e-mail me postën elektronike konfirmojnë përsëri pretendimin e tyre për çmimin e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare;
 5. Neofone sh.p.k në përgjigje të email-it të Vodafone AL sh.a dërgon shkresën nr. 55 datë, datë 06.12.2010 ku i ripërsërit Vodafone AL që pretendimi i tyre për tarifën e terminimit është i pabazuar dhe tërësisht abuziv;
 6. Për sa më sipër, Neofone vlerëson se në të gjitha përgjigjet e Vodafone Albania mungon një arsyetim ligjor për çdo respektim dhe bllokim të qarqeve në mënyrë të njëanshme. Neofone në zbatim të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, propozon për AKEP masat rregullatore si më poshtë:
 - Detyrimin e Vodafone AL për alokimin e qarkut të ri të E1 të kërkuar nga Neofone sh.p.k, facilitet i cili do të lejojë akses të plotë për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare dhe kombëtare;
 - Ripërcaktimin dhe interpretimin e qartë të çmimit të terminimit midis Neofone sh.p.k dhe Vodafone AL sh.a duke nisur nga data 03.11.2010 që përkon me daljen e Vendimit nr. 1437, datë 03.11.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP;
 - Përcaktimin e modaliteteve të aksesit dhe interkoneksionit midis Neofone sh.p.k dhe Vodafone Albania sh.a;
 - Ndërmarrjen e sanksioneve ligjore kundrejt shkeljeve të njëpasnjëshme të bëra nga Vodafone Albania në bazë të neneve 60,135 dhe 137, të ligjit nr. 9918;
 - Legjitimitimin e humbjeve financiare të shkaktuara në drejtim të Neofone sh.p.k.
 7. Neofone me anë të shkresës nr. 64 prot, date 14.01.2011 me subjekt “Paralajmërim për mbylljen në mënyrë të njëanshme të Aksesit dhe interkoneksionit nga Vodafone AL sh.a” bashkëlidhur korrespondenca me e-mail midis tyre, bën me dije se Vodafone AL në vazhdimësi pretendon aplikimin e tarifës 0.15 Euro/min, për periudhën 03.11.2010 deri më 23.11.2010, duke arsyetuar se ankimi administrativ i Vodafone AL ka pezulluar veprimin e Vendimit nr. 1437 datë 03.11.2010 të AKEP.

Për sa më sipër Vodafone AL, me anë të e-mail-it të datës 11.01.2011 drejtuar Neofone “Mbi debitin e papaguar të faturës së muajit Nëntor 2010”, njofton se për shkak se janë ezauruar afatet e maturimit që prej 12 ditësh për faturën e muajit Nëntor 2010, pjesërisht e papaguar nga Neofone, Vodafone AL ne zbatim të Aneksi 3 të MI duke filluar nga data 17.01.2011 do të ndërpresë trafikun e interkoneksionit me Neofone deri në momentin e kryerjes së pagesave për detyrimin përkatës;

8. Neofone me shkresën nr. 66 prot, datë 24.01.2011, “Njoftim në lidhje me ndërprerjen e aksesit të interkoneksionit nga ana e Vodafone AL, dhe kërkesë për ndërhyrjen e menjëhershme të AKEP për hapjen e kapaciteteve të Interkoneksionit”, konsideron se Vodafone AL ka marrë një hap jo korrekt në lidhje me ndërprerjen e kapaciteteve të interkoneksionit me Neofone.

Neofone sqaron se nuk i është shmangur asnjë detyrimi që rrjedh nga Vendimet e AKEP, dhe ka qenë gjithmonë i rregullt në pagesat e kryera kundrejt Vodafone AL;

Neofone konsideron se Vodafone AL me ndërprerjen e kapaciteteve të interkoneksionit me date 21.01.2011 ka përsëritur veprimin e saj abuziv të datës 01.11.2010;

- II.** Vodafone me shkresën nr. CEO/0130/E.Xh., datë 17.12.2010 (AKEP nr. 3472/3 prot, datë 20.12.2010) “Dërgohen prapësimet e Vodafone Albania në lidhje me Vendimin nr. 1454, datë 03.12.2010 “Për fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve Neofone dhe Vodafone AL sh.a”, sqaron se:

1. AKEP, në zbatim të nenit 75 dhe 103 të K.Pr.A duhet të pushojë procedimin administrativ pasi nuk ekziston më shkak ligjor për vazhdimin e tij;
2. Kërkesa e Neofone për shtim kapaciteti nuk është në përputhje me dispozitat rregullatore dhe si e tillë është e pabazuar në ligj, e parregullt dhe e pazbatueshme.
3. Negociatat midis palëve për tarifën e shërbimit kanë qenë të plota të rregullta dhe janë zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
4. Vodafone nuk ka kufizuar akses në facilitetet për asnjë moment, duke vepruar në përputhje të plotë me Ligjin nr. 9918, datë 19.05.2010;
5. Vendosja e tarifës së trafikut ndërkombëtar nga Vodafone është bërë sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 9918 dhe masa e kësaj tarife ka qenë në kufij normale të absorbimit nga tregu;
6. Vodafone nuk ka vendosur në dispozicion të Neofone shërbimin e terminimit të trafikut ndërkombëtar nga data 01.11.2010 deri më 03.11.2010, pasi Neofone ka refuzuar të paguajë për këtë shërbim.
7. Vodafone ka vendosur në dispozicion të Neofone shërbimin e terminimit të trafikut ndërkombëtar sapo Neofone ka vendosur të pranojë tarifën dhe të paguajë për këtë shërbim;
8. Vodafone për asnjë çast nuk ka cënuar Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës”;
9. Për sa më sipër Vodafone kërkon rrëzimin e ankimit administrativ të Neofone sh.p.k, dhe mbylljen e procedimit administrativ;

III. AKEP, në seancën dëgjimore të mbajtur në selinë e AKEP me datë 27.01.2010 midis palëve në procedim vëren se:

Neofone :

1. Neofone i qëndron kërkesës për shtim kapaciteti me 1 E1 të dytë, duke theksuar se ka kryer investim për lidhjen fizike të rrjetit me Vodafone duke pritur vetëm lidhjen logjike nga ana e Vodafone;
2. Neofone shprehet se në datën 31 Tetor 2010, ka gjeneruar trafik më shumë se 1E1, ndërsa në 01.11.2010 Vodafone AL, ka ndërprerë lidhjen ekzistuese E1 te interkoneksionit për Neofone dhe e ka lidhur atë vetëm pas pranimit nga ana e Neofone te tarifës së Vodafone AL deri në daljen e një VKD të re nga AKEP për tarifën e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, duke i hapur Neofone vetëm 3 kanale nga 30 të facilitetit ekzistues;
3. Vodafone edhe pas Vendimit nr. 1437, date 03.11.2010 të AKEP vetëm më datë 23.11.2010 e ka zhbllokuar aksesin në facilitetet ekzistuese me Neofone;
4. Gjithashtu Vodafone më datë 21.01.2011, ka ndërprerë përsëri interkoneksionin me Neofone për moslikujdim fature nga ana e Neofone, duke aplikuar në këtë faturë tarifën prej 0.15 Euro/min;
5. Së fundmi Neofone kërkon nga AKEP:
 - a) Rilidhjen e E1 fillestar;
 - b) Shtimin e kapacitetit me 1E1 të ri nga ana e Vodafone;
 - c) Interpretimi të Vendimit nr 1437, të Keshillit Drejtues të AKEP, për tarifën e Vodafone.

Vodafone AL:

1. Vodafone lidhur me pretendimin e Neofone për vetëm 3 “kanale” të hapura nga E1-shi fillestar, edhe në provat e paraqitura edhe në takimin e datës 27.01.2011, sqaron se thjesht ka bërë riorganizim kanalesh nga E1-shi fillestar dhe konkretisht i ka vendosur Neofone 3 kanale për thirrjet kombëtare dhe pjesa tjetër për thirrjet ndërkombëtare meqenëse nga data 01.11.2010, tarifa e terminimit për thirrjet kombëtare do të ishte e ndryshme nga tarifa e thirrjeve ndërkombëtare. Riorganizimi i kanaleve është bërë bazuar në parashikimin e trafikut të dërguar nga Neofone;
2. Vodafone i përmbahet qëndrimeve që ka mbajtur deri tani në lidhje me mosmarrëveshjen në fjale, në zbatim të ligjit, RIO dhe MI midis palëve dhe përsërit se ankimimi i Neofone nuk ka objekt dhe bazë ligjore të qartë;
3. Në kushtet e mospagimit të faturës ka ndërprerë interkoneksionin me Neofone, por jo MI mes palëve;
4. Ky detyrim i është rikujtuar Neofone edhe me email-in e datës 14.01.2011, ku ndër të tjera është njoftuar për miratimin nga AKEP të Ofertës Referencë të Interkoneksionit të re (ORI);

5. Në lidhje me shtimin e kapacitetit me 1 E1, nga Vodafone ne datën 09.11.2010 ka ftuar Neofone per konfigurimin e E1 te dyte dhe hapjen e kapacitetit përkatës. Përfaqësuesit e Neofone janë paraqitur ne ambientet teknike te Vodafone dhe janë kryer veprimet teknike. *(kjo u pranua dhe nga përfaqësuesit e Neofone ne takimin e datës 27.01.2011).* Me tej, Vodafone nuk e ka vene E1-shin e dyte ne funksionim logjik sepse parashikimi i trafikut ndërkombëtar mujor nga Neofone ka qene ne nivele mjaft te uleta dhe sjell ne vëmendje parashikimet e Neofone ne zbritje nga afërsisht 700 000 minuta ne 62 000 minuta dhe me vone ne 30 000 minuta, si dhe parashikimin e trafikut kombëtar mujor me reduktim deri ne 1500 minuta. Me një kalkulim te thjeshte matematik, Vodafone sqaron se mjaftonte 1 kanal i E1-shit aktual për përballimin e trafikut te parashikuar se fundmi nga Neofone. Sipas Rio-s ne fuqi, shtimi i kapacitetit E1 und te behej nga Vodafone Albania nëse trafiku i realizuar ne momentin e kërkesës te ishte realizuar mbi 75 % e kapacitetit E1 aktual dhe ndërkohë trafiku i Neofone pësonte ulje drastike;
6. Lidhur me shtimin e kapacitetit E1, Vodafone sqaron se i ka bere me dije Neofone qe bazuar ne përcaktimet e RIO-s (së re) te miratuar me VKD nr. 1468 date 23.12.2010, ka ftuar Neofone te beje parashikimin e trafikut dhe shprehet e gatshme për diskutimin e mundësisë së lidhjes se 2 E1 si dhe nënshkrimin e marrëveshjes se interkoneksionit brenda afateve te përcaktuara nga AKEP. Deri ne 27.01.2011, Neofone nuk i ka thyer përgjigje Vodafone;
7. Vodafone shprehet se nga Neofone nuk është paraqitur asnjë provë në lidhje me ndërprerjen e kanaleve të interkoneksionit për periudhën që pretendohet, (në formë të printuar nga sistemi teknik i Neofone), pavarësisht se në shkresa është paraqitur si problem.

IV. Sa më sipër, Këshilli Drejtues i AKEP, vlerëson se:

1. Palët, në lidhje me shtimin e kapaciteteve E1 të kërkuara nga Neofone, duhet të marrin parasysh e të zbatojnë parashikimet e Vendimit nr. 1468 datë 23.12.2010, të Këshillit Drejtues të AKEP, për “Miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a”;
2. Për sa i përket interpretimit të Vendimit nr. 1437, datë 03.11.2010, “*Për disa ndryshime ne VKD nr. 1347, datë 23.07.2010 “ Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone për ndryshimin të aktit administrativ Vendim nr. 1211, datë 31.03.2010, të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone sh.a., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”*, megjithëse është ankimuar nga Vodafone me datë 17.11.2010, AKEP me VKD nr. 1452, datë 22.11.2010, pika 1, e ka rrezuar kërkesën ankimore, duke e lënë ne fuqi VKD nr. 1437, datë 3.11.2010;
3. Në interpretim të neneve 135, e në vijim të K. Pr. A, efektet juridike të Vendimit nr. 1437 date 03.11.2010 pas ankimit te Vodafone janë pezulluar deri në daljen e një Vendimi nga AKEP, i cili pasi ka shqyrtuar ligjshmërinë dhe rregullsinë e aktit te kontestuar ka dalë me Vendimin nr. 1452, date 22.11.2010 duke rrezuar kërkesën ankimore te Vodafone dhe ka

lënë në fuqi Vendimin nr. 1437, date 03.11.2010, si rrjedhojë bien efektet e pezullimit të Vendimit 1437, dt. 03.11.2010, dhe efektet e tij juridike fillojnë më datë 03.11.2010.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të mbyllë procedimin administrativ të filluar me VKD nr. 1454 datë 03.12.2010 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis “Neofone” sh.p.k dhe “Vodafone Albania” sh.a.;
 2. Vodafone Albania të zbatojë Vendimin nr. 1437, datë 03.11.2010, “*Për disa ndryshime në VKD nr. 1347, datë 23.07.2010 “Për shqyrtimin e ankimit administrativ të Vodafone për ndryshimin të aktit administrativ Vendim nr. 1211, datë 31.03.2010, të AKEP “Për përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone sh.a., me fuqi të ndjeshme në treg dhe vendosjen e masave rregulluese”*, i cili ka hyrë në fuqi në datën 03.11.2010;
 3. Vodafone Albania sh.a, të rivendosë lidhjen e interkoneksionit për kapacitetin 1E1 ekzistues me Neofone sh.p.k, brenda 3 ditëve nga marrja e njoftimit të Vendimit;
 4. Palët në lidhje me shtimin e kapacitetit me 1 E1 për Neofone sh.p.k, të zbatojnë Vendimin nr. 1468, datë 23.12.2010, të Këshillit Drejtues të AKEP, Për “Miratimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Vodafone Albania sh.a.”;
 5. Të njoftohen palët e interesuara “Neofone” sh.p.k dhe “Vodafone Albania” sh.a për mbylljen e procedimit administrativ;
 6. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al
- Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURÇE**